



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

**INSPEKTIMIN TEMATIK NË LIDHJE ME
DEKLARIMIN E STATUSIT TË PUNËSIMIT DHE VLERËSIMIN E REZULTATEVE
TË PUNËS**

BASHKIA ORIKUM

Njësia Administrative Orikum
BASHKIA VLORE

Tiranë, Nëntor 2015

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për kryerjen e inspektimit tematik në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës

Hyrje

Në bazë të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në përgjigje të kërkesës për bashkëpunim të Kryetarit të Bashkisë Orikum, rregjistruar me nr. 829 prot., datë 18.05.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 53, datë 28.05.2015, “Për kryerjen e inspektimit tematik në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civilë në institucionin, Bashkia Orikum”, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit tematik në këtë institucion.

Objekti i inspektimit është vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e Bashkisë Orikum, të cilët kanë qenë efektivë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, (data 26.02.2014), vlerësimi vjetor i rezultateve të punës, si dhe probleme të tjera që mund të lindin gjatë zbatimit në praktikë të ligjit për nëpunësin civil.

Inspektimi është realizuar sipas programit dhe procedurës së miratuar, pasi është bërë njoftimi paraprak i institucionit nëpërmjet shkresës nr.400/2 prot., datë 28.05.2015 “Njoftim për fillimin e inspektimit tematik”.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial që kanë pësuar njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”, ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Orikum, aktualisht është organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilës, janë pjesë e strukturës dhe organikës të administratës së Bashkisë Vlorë.

Në bazë të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, “Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”, pika 1 e tij, bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë, përfshirë edhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, në nëntitullin “Transferimi i personelit”, parashikohet se, marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrirë dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njësisë të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit për miratimin e raportit përfundimtar, do t'i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, si institucioni përgjegjës në këtë rast.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i inspektimit, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e inspektimit në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësit dhe vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civilë në institucionin, Bashkia Orikum, të cilin ia ka dërguar për njohje institucionit përgjegjës në këtë rast, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 400/4 prot., datë 14.08.2015, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për t'u shprehur në lidhje me pretendimet dhe observacionet për projektraportin, rezulton se me shkresën nr. 50207, datë 11.11.2015, nga ana e Bashkisë Vlorë është kthyer materiali i nënshkruar, pa vërejtje apo kundërshtime në lidhje me gjetjet dhe përfundimet e arritura prej grupit të inspektimit.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson të përmbushur detyrimin ligjor për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i inspektimit do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit përkatës për miratimin e tij.

Qëllimi i inspektimit:

- Kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*";
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve e fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil;
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

Objekti i inspektimit:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përkrahimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;

- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr.8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
 - Respektimi i kërkesave ligjore në plotësimin e formularit të vlerësimeve të rezultateve të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.
3. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Metodologjia e inspektimit

Inspektimi ka përfshirë zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me respektimin e kërkesave ligjore në procesin e deklarimit të statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar (data 26.02.2014).

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në vendimin nr. 53, datë 28.05.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, grupi i inspektimit ka verifikuar dhe ka shqyrtuar dokumentacionin nëpërmjet këqyrjes së materialeve të administruara në dosjet e personelit dhe në arkivën e institucionit.

- Janë verifikuar të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit.
- Janë verifikuar procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër, e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;
- Janë verifikuar nëse vlerësimet individuale të punës për pozicionet pjesë të shërbimit civil, janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar;
- Janë verifikuar të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimit, përvoja në punë e të tjera;
- Janë verifikuar listëpagesat e muajit shkurt 2014 dhe listëpagesat e muajit qershor 2015 për të gjithë punonjësit e institucionit, si dhe materiale të tjera që kanë lidhje me procesin e inspektimit.

Konstatimet e inspektimit janë të materializuara si aneks më vete, në formën e tabelës që është pjesë e këtij projektraporti, nën emërtimin: **Aneksi I - “Organigrama dhe historiku i marrëdhënies me shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Orikum”**.

Përmbajtja e raportit:

I. Deklarimi i statusit të punësimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

1. Strukturimi i institucionit dhe ndarja e pozicioneve të punës në momentin e inspektimit.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të tij, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë.

Në rastin konkret, subjekti i inspektimit, është konstatuar se funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 28.01.2015 të Këshillit të Bashkisë Orikum “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të Bashkisë Orikum për vitin 2015” dhe të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Bashkisë Orikum, të miratuar me vendimin nr. 11, datë 30.03.2014, Kryetarit të Bashkisë Orikum. Rregullorja është bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe ka përcaktuar misionin e institucionit dhe procedurën e vlerësimit të pozicioneve të mbetura, në kushtet e riorganizimit, në përputhje me detyrat e përgjegjësitë e reja; detyrat funksionale të sektorëve dhe nëpunësve të tyre.

Nga dokumentacioni i administruar, është konstatuar se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në datë 26.02.2014, subjekti i inspektuar, ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me vendimin nr. 2, datë 15.01.2014 të Këshillit Bashkiak. “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të Bashkisë Orikum për vitin 2014”

Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, si dhe duke krahasuar strukturën e institucionit në momentin e mbikëqyrjes, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 28.01.2015 të Këshillit Bashkiak, “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të Bashkisë Orikum për vitin 2015”, me atë të mëparshme, të miratuar me Vendimin nr.2, datë 15.01.2014 të Këshillit Bashkiak “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të

Bashkisë Orikum për vitin 2014”, rezulton se administrata e Bashkisë Orikum nuk ka pësuar ndryshime.

Subjekti i mbikëqyrur ka gjithsej **55** pozicione pune, nga të cilët **24** pozicione pune , rregullohen nëpërmjet Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe **31** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, rezulton të jenë **7** pozicione, që i përkasin kategorisë “*Drejtor drejtorie*”.
 - Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues është **1** pozicion pune, i cili i përket kategorisë “*Kryeinspektor*”.
 - Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **23** pozicione pune, të cilat i përkasin kategorisë “*Inspektor*”.
2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që institucioni i Bashkisë Orikum ka qënë dhe mbetet pjesë e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për secilin nëpunës, që fillimi i efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e gjeti në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, duhet të bëhet në kushtet dhe kërkesat që parashikohen prej nenit 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku në mënyrë të shprehur, thuhet:

- *pika 3, “Nëpunësit civil ekzistues”,* punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi nëpunësit civil*”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë;
- *pika 4, “Nëpunësit ekzistues”,* që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji;
- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit”,* sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit.

Po kështu, në vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.*

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbante parasysh njësia përgjegjëse, për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me faktin nëse veprimet e njësisë të burimeve njerëzore janë kryer në përputhje me kërkesat e dispozitave të mësipërme, grupi i inspektimit mblodhi, verifikoi dhe analizoi materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, sidomos organigramën dhe strukturën analitike të institucionit, që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit (të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2014 të Këshillit Bashkiak, “*Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të Bashkisë Orikum për vitin 2014*”), procedurën e rekrutimit për secilin nëpunës si dhe të dhënat personale.

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, mund t’u kategorizojmë në këtë mënyrë:

2/a. Nëpunës të cilëve u është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë të konfirmuar.

Pas verifikimit të akteve të deklarimit të statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se punonjës që kanë fituar statusin e nëpunësit civil sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 1, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, janë nëpunësit si më poshtë:

1. *****, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Personelit”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 3 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.
Marrëdhënia e punës me institucionin, ka filluar me vendimin e titullarit nr. 33, datë 05.10.2011 “Emërim në detyrë”, në pozicionin Drejtorë e Personelit, (pa procedurë konkurrimi). Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer të njëjtën detyrë, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfitur statusin e nëpunësit civil të konfirmuar.

2. *****, në pozicionin “Inspektor Protokoll Arshivës dhe Sekretare e kryetarit” në Drejtorinë e Performancës dhe Marrëdhënieve me Publikun”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 6 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.

Marrëdhënien e punësimit me institucionin, rezulton që e ka filluar me urdhrin e titullarit nr. 15, datë 01.03.2012 “Emërim në detyrë”, në pozicionin “Inspektor i Protokoll Arshivës dhe Sekretare e Kryetarit”, (pa procedurë rekrutimi). Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer të njëjtën detyrë, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfitur statusin e nëpunësit civil të konfirmuar.

3. *****, në pozicionin “Inspektor Informacioni (IT) në Drejtorinë e Performancës dhe Marrëdhënieve me Publikun”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 7 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil.

Rezultoni se marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum e ka filluar në dt. 08.12.2006, si “mirëmbajtës rrjeti kompjuterik” dhe më pas, me urdhrin nr. 70, datë 27.12.2011 të drejtuesit të institucionit “Transferim në detyrë”, pa respektuar procedurën ligjore, ka kaluar në pozicionin që mban aktualisht. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ky nëpunës ka kryer detyrën e mësipërme, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, e ka përfitur statusin e nëpunësit civil.

4. ***** në pozicionin “Inspektore Auditi në Drejtorinë e Performancës dhe Marrëdhënieve me Publikun”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 9 prot, datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.

Marrëdhënia e punës me institucionin sipas librezës së punës ka filluar në datën 15.12.2000, si ekonomiste. Është e pajisur me çertifikatë “Auditues i brendshëm i sektorit publik”, kërkesë kjo e domosdoshme për të mbajtur pozicionin aktual si inspektore auditi. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfitur statusin e nëpunësit civil në këtë pozicion.

5. ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 10 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil.

Marrëdhënien e punës me institucionin e ka filluar me vendimin e titullarit nr. 9, datë 06.04.2007 “Emërim në detyrë”, në pozicionin “Drejtor i Zyrës Urbanistike” (pa procedura rekrutimi sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”) dhe ka vazhduar pa ndërprerje në këtë pozicion edhe në momentin e inspektimit. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” ky nëpunës ka kryer detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfitur statusin e nëpunësit civil të konfirmuar, në këtë pozicion.

6. ***** në pozicionin “Inspektore Urbanistike në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit”, deklaruar statusi i të punësimit me aktin nr. 12 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum e ka filluar në dt. 16.02.2005, me emërim, pa kryer procedurë konkurimi, në pozicionin inxhiere në Sektorin e Shërbimeve. Më pas, me vendimin e titullarit nr. 1, datë 12.03.2010 “Emërim në detyrë”, (përsëri pa procedurë rekrutimi) ka kaluar në pozicionin që mban sot, “inspektore urbanistike”. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfitur statusin e nëpunëses civile të konfirmuar, në pozicionin “Inspektore Urbanistike në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit”.

7. ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Programim Zhvillimit”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 13 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Juridike, Turizmit dhe Programim Zhvillimi”.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum, e ka filluar në dt. 09.01.2009 në pozicionin “Drejtores e Zyrës Juridike”, me akt emerimi pa kryer procedurë konkurimi sipas parashikimeve të ligjit të mëparshëm për shërbimin civil. Në pozicionin aktual ka kaluar me

urdhrit e titullarit nr. 56, datë 27.12.2012 “*Transferim në detyrë*”, (përsëri pa procedurë konkurrimi). Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer për më shumë se një vit, detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfituar statusin e nëpunëses civile të konfirmuar, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Programim Zhvillimit*”.

8. *****; në pozicionin “*Inspektor Jurist në Drejtorinë Juridike dhe Programim Zhvillimit*”, deklaruar statusi i punësimit, me aktin nr. 14 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum, për herë të parë e ka filluar në dt. 01.02.2011 në pozicionin “*Inspektor i Koordinim Zhvillimit*”, pa kryer procedurë konkurrimi sipas ligjit të mëparshëm. Në pozicionin aktual, ka kaluar me urdhrin e titullarit nr. 17, datë 05.06.2013 “*Transferim në detyrë*”, (përsëri pa procedurë konkurrimi). Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer për më shumë se një vit, detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfituar statusin e nëpunëses civile të konfirmuar, në pozicionin “*Inspektor Jurist në Drejtorinë Juridike dhe Programim Zhvillimit*”.

9. *****; në pozicionin “*Inspektor Arsimit në Drejtorinë Juridike dhe Programim Zhvillimit*”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 1 prot., datë 24.03.2014 si nëpunës civil.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum e ka filluar me vendimin e titullarit nr. 11, datë 01.02.2011 “*Emërim në detyrë*”, (pa procedura rekrutimi sipas ligjit të mëparshëm për shërbimin civil), në pozicionin “*Inspektor i Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Shëndetësisë*”, i cili është i njëjtë me pozicionin që mban aktualisht. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ky nëpunës ka kryer për më shumë se një vit, detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfituar statusin e nëpunësit civil të konfirmuar, në pozicionin “*Inspektor Jurist në Drejtorinë Juridike dhe Programim Zhvillimit*”.

10. *****; në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës Pyjeve Kullotave*”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 16 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum e ka filluar në dt. 15.5.1997, në pozicionin “*Inspektore e bujqësisë*”. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, ka fituar për shkak të ligjit statusin e nëpunësit civil. Në pozicionin aktual, ka kaluar me vendimin nr. 9, datë 06.02.2012 të titullarit “*Transferim në detyrë*”, (pa procedurë për ngritje në detyrë sipas ligjit të mëparshëm). Megjithatë, duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer për më shumë se një vit, detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4 të nenit 67 të ligjit në fjalë, ka përfituar statusin e nëpunëses civile, në pozicionin “*Drejtores në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës Pyjeve Kullotave*”.

11. *****; në pozicionin “*Inspektor i Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës Pyjeve Kullotave*”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 10 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum e ka filluar në dt. 15.5.1997, në pozicionin “Inspektor i bujqësisë” dhe vazhdon pa ndërprerje. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, ka fituar për shkak të ligjit statusin e nëpunësit civil, në pozicionin “Inspektor i Bujqësisë”. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky nëpunës ka vijuar të kryejë detyrën në të njëjtin nivel dhe në të njëjtën fushë, me të drejtë në bazë të pikës 4 të nenit 67 të ligjit në fjalë, i është deklaruar statusi i nëpunësit civil, në pozicionin “Inspektor i Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës Pyjeve Kullotave”.

12. *****, në pozicionin “Inspektor buxheti në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 2 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum, për herë të parë e ka filluar në dt. 27.10.2008 në pozicionin e punës “Sekretare e kryetarit të bashkisë dhe Inspektore e Protokoll-arkivës”.

Në pozicionin aktual ka kaluar me urdhrin e titullarit nr. 14, datë 01.03.2012 “Emërim në detyrë”, (pa procedurë konkurrimi sipas ligjit të mëparshëm). Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo nëpunëse ka kryer për më shumë se një vit, detyrën e mësipërme, me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ka përfituar statusin e nëpunëses civile, në pozicionin “Inspektore buxheti”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike.

13. *****, në pozicionin “Inspektore Finance në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 20 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil, në pozicionin “Inspektor Finance”.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum e ka filluar, për herë të parë, në dt. 01.08.1991, me detyrën “Shefe Finance”. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, ka fituar për shkak të këtij ligji, statusin e nëpunëses civile. Në pozicionin aktual është rikonfirmuar me urdhrin e titullarit nr. 32, datë 01.10.2013 “Transferim në detyrë”. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo nëpunëse me të drejtë në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, është konfirmuar, nëpunëse civile në pozicionin “Inspektore Finance në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”.

14. *****, në pozicionin “Inspektor Social dhe Statistike në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 17 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum e ka filluar në pozicionin që mban aktualisht, me vendimin e titullarit nr.8, datë 01.02.2011 “Emërim në detyrë” (pa procedurë konkurrimi sipas parashikimit të ligjit të mëparshëm). Megjithatë, duke qënë se, fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” e ka gjetur në këtë pozicion, me një vjetërsi më shumë se një vit, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, është konfirmuar si nëpunëse civile në pozicionin “Inspektore Sociale dhe Statistike në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”.

15. *****, në pozicionin “Inspektore Kontrolli dhe Vlerësimit Tatimor në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, deklaruar statusi i punësimit me

aktin nr. 5 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile, në pozicionin “Inspektor Tatimesh”.

Marrëdhënien e punës me institucionin e bashkisë e ka filluar në dt.01.03.2006, në pozicionin “Inspektore turizmi dhe mjedisi”, pa kryer më arë procedurë konkurrimi. Më pas, me vendimin e titullarit nr. 16, datë 14.05.2007 “Ndryshim pozicioni në detyrë”, (përsëri pa procedurë për lëvizje paralele) ka kaluar në pozicionin aktual. Megjithatë, duke qënë se fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, me një vjetërsi më shumë se një vit, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, është konfirmuar, si nëpunëse civile në pozicionin “Inspektore Kontrolli dhe Vlerësimi Tatimor në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”.

16. *****, në pozicionin “Inspektor Rregjistrimit të Bisnesit të Vogël dhe të Madh në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, deklaruar statusi i punësimit nr. 15 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil, në pozicionin “Inspektor Tatimesh”.

Marrëdhënien e punës me institucionin e bashkisë e ka filluar në dt. 14.05. 2007, në pozicionin “Inspektor Turizmi”, pa kryer më parë procedurë konkurrimi. Në pozicionin aktual ka kaluar me vendimin e titullarit nr. 8, datë 03.02.2014 “Transferim në detyrë”, (përsëri, pa kryer procedurë për lëvizje paralele). Megjithatë, duke qënë se fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, është konfirmuar, nëpunës civil në pozicionin “Inspektor Rregjistrimit të Bisnesit të Vogël dhe të Madh në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”.

17. *****, në pozicionin “Drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Punëve Publike”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 18 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil në pozicionin e mësipërm.

Marrëdhënien e punës me Bashkinë Orikum e ka filluar me vendimin e kryetarit të bashkisë nr. 32, datë 05.10.2011 “Emërim në detyrë” dhe kontratën individuale të punës nr. 861 prot., datë 06.10.2011 (pa procedura rekrutimi sipas ligjit të mëparshëm). Megjithatë, duke qënë se fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, për një periudhë më shumë se një vit, me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, është konfirmuar, nëpunës civil në pozicionin “Drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Punëve Publike”.

Sa analizuam më lart, rezulton se njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në momentin e deklarimit të statusit të punësimit në lidhje me punonjësit që janë gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Nga ana tjetër, konstatohet se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nuk ka realizuar asnjë procedurë ligjore për të plotësuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në përputhje me ligjin e kohës, i cili përcaktonte konkurrimin si të vetmen mënyrë për t'u punësuar në një pozicion pune, pjesë e këtij sistemi, e për pasojë asnjë prej punonjësve nuk e gëzonte statusin e nëpunësit civil, me përjashtim të rasteve që e kanë përfituar këtë status për shkak se janë gjendur në punë, në momentin e hyrjes në fuqi të atij ligji.

Kjo praktikë ka sjellë si pasojë mos përmbushjen e qëllimit të ligjit të kohës, për statusin e nëpunësit civil, por që është koherent edhe me ligjin aktual për nëpunësin civil, për një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë.

2/b. Nëpunësit të cilëve i është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë në periudhë prove.

Nisur nga verifikimi i akteve të deklarimit të statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, rezulton se punonjësit që kanë fituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove, sipas kërkesave të pikës 4, të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, janë si më poshtë:

1. *****, në pozicionin "Drejtorë në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike", deklaruar statusi i punësimit në këtë pozicion pune me aktin nr. 25 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile në periudhë prove.

Konstatohet se marrëdhënien e punës me institucionin, për herë të parë, e ka filluar në dt. 20.10.1993 në pozicionin ekonomiste finance (sipas emrtimit të kohës). Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ajo ka përfituar statusin e nëpunësit civil, në nivelin ekzekutiv (inspektore finance).

Në vitet e mëvonshme ka bërë disa lëvizje në detyrë, ndër të cilat:

- me Urdhërin nr. 33, datë 01.10.2013, ka kaluar nga pozicioni i punës "Inspektore Finance" në pozicionin "Drejtorë Tatimesh";
- me Urdhërin nr. 6, datë 03.02.2014, ka kaluar nga pozicioni "Drejtorë e Tatimeve", në detyrën "Përgjegjëse e Tatimeve";
- me Urdhërin nr. 11, datë 21.02.2014, ka kaluar nga pozicioni "Shefe e Sektorit të Tatimeve", përsëri në detyrën "Drejtorë e Drejtorisë së Menaxhimit të Financave Publike", ku edhe ndodhet aktualisht. Ndërkohë, sipas listëpagesës së institucionit, rezulton se marrëdhëniet financiare në lidhje me këtë pozicion pune i kanë filluar në datën 01.04.2014.

Duhet theksuar, se të gjitha këto lëvizje në detyrë, janë bërë pa respektuar procedurat e kërkuara nga legjislacioni i shërbimit civil i kohës dhe janë pranuar nga ana e saj.

Nga sa parashtruam më sipër, rezulton se data e aktit administrative me të cilin është realizuar ngritja e fundit në detyrë është bërë, para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe nga ana tjetër konstatohet se marrëdhëniet financiare me pozicionin e drejtorit, ka filluar në datën 01.04.2014, pra pasi kishin filluar efektet juridike të ligjit të ri.

Ndërkohë, konstatohet se njësia e personelit e ka deklaruar statusin e punësimit të saj, si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin "Drejtorë në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike".

Duke analizuar këtë procedurë administrative të ndjekur gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit, konstatohet se nga ana e njësisë përgjegjëse që e ka realizuar këtë proces është vepruar gabim si në momentin e përcaktimit të klasës së nëpunësisë civile ashtu edhe në përcaktimin e rastit si nëpunës civil, në periudhë prove.

Së pari, njësia përgjegjëse, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit në këtë rast, me fillimin e efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në zbatim të nenit 67 të tij, ka marrë të mirëqenë, si ditën e fillimit të efekteve të punësimit datën 21.02.2014, që përkon me nxjerrjen e aktit të emërimit nga Kryetari i Bashkisë.

Për rrjedhojë, procesi i deklarimit të statusit të punësimit është bërë në pozicionin e përcaktuar në këtë akt dhe jo në pozicionin që ka patur realisht në datën e fillimit të efekteve të ligjit, “*Shef i Sektorit të Tatimeve*”.

Ky veprim vlerësohet i kryer në kundërshtim me mënyrën se si duhet kuptuar dhe zbatuar legjislacioni që rregullon hyrjen në fuqi të akteve administrative dhe funksionimin e administratës publike.

Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se akti administrativ (akti i emërimit nga Kryetari i Bashkisë) është një akt administrativ individual që rregullon një marrëdhënie konkrete të posaçme, për një çështje të caktuar, ndaj një subjekti të identifikueshëm, që në rastin konkret janë punonjësit e Bashkisë Orikum. Edhe pse vetë akti nuk e ka përcaktuar karakterin e tij individual, ai del nga vetë përmbajtja e tij, nga marrëdhënia juridike që rregullon, si dhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijon për subjektet ndaj të cilëve i shtrin efektet.

E parë në këtë kontekst, ky akt që rregullon këtë marrëdhënie të posaçme, duhet të përmbajë njëkohësisht të gjitha elementet e marrëdhënies së punës. Marrëdhënia e punës lind me përmbushjen e tre kushteve: ekzistencën e pozicionit të punës, kryerjen e detyrës nga nëpunësi përkatës dhe pagesën për punën e kryer. Nëse njëri nga këta elementë nuk ekziston, atëherë nuk mund të flitet për marrëdhënie pune; apo nëse një nga këta elementë ndryshon, atëherë lind një marrëdhënie e re pune.

Në këto rrethana, në nenin 111 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se aktet administrative hyjnë në fuqi ditën e miratimit të tyre, duke përjashtuar rastin kur vetë akti i jep, *fuqi të vonuar*.

Fakti që në aktin e emërimit është shënuar një datë e mëvonshme për fillimin e efekteve financiare, do të thotë se urdhërdhënësi ka shprehur vullnetin që këto marrëdhënie pune të krijuara, të bëhen efektive në momentin e fillimit të marrëdhënieve financiare dhe jo në momentin e daljes së aktit.

Sa më sipër, konstatojmë se, pavarësisht datës së formulimit dhe nënshkrimit të aktit nr. 11, datë 21.02.2014, ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ky akt nuk kishte hyrë në fuqi, pasi kishte të caktuar në vetë përmbajtjen e tij, ditën e fillimit të gjithë efekteve juridike, për subjektin e përmendur në të.

Në këto kushte, deklarimi i statusit të punësimit në rastin konkret duhej të bëhej në bazë të gjendjes faktike të punësimit në datë 26.02.2014, domethënë, të pozicionit të punës që ka patur realisht nëpunësi ditën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ky moment duhet të përbëjë kriterin bazë të vlerësimit, për të arritur në konkluzionin se në cilin pozicion pune duhet deklaruar statusi i punësimit për punonjësen në fjalë.

Së dyti, në përmbajtjen e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konkretisht në pikën 4 të tij, referohet që të zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji, që rregullon periudhën e provës, për të gjithë ata punonjës, që ligji i gjeti për një periudhë më të vogël se 1 vit, në pozicionin ku ata fitojnë statusin e nëpunësit civil.

Ndërkohë, rezulton që, neni 24 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është i përfshirë në Seksionin 2 të këtij ligji, i cili rregullon procedurën e pranimit në shërbimin civil, në nivelin ekzekutiv. Nga ana tjetër, për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, të cilët plotësohen nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, apo në raste përjashtimore me pjesmarrës nga jashtë, sipas nenit 26 të këtij ligji, nuk parashikohet në asnjë moment periudha e provës, pra punonjësit që i përkasin këtyre niveleve, nuk i nënshtrohen periudhës së provës.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me ligjin duke e cilësuar punonjësen e përmendur në këtë rast në kategorinë e nëpunësve të nivelit të mesëm drejtues dhe njëkohësisht, përfshirjen e saj në periudhë prove.

Konkluzion: Për të gjitha arsyet e analizuar më sipër, Komisioneri vlerëson se duhet të revokohet akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për punonjësen *****, në pozicionin e punës Drejtor Drejtorie dhe t'i deklarohet statusi i punësimit “nëpunës civil”, i konfirmuar në pozicionin “*Shefi i Sektorit të Tatimeve*”.

Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Financave Publike”, duhet të shpallej si pozicion i lirë dhe të plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore që rregullojnë institutin e rekrutimit në shërbimin civil.

2. *****, aktualisht në pozicionin “*Shefe e Sektorit të Tatim Taksave, në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike*”.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum, e ka filluar për herë të parë në dt.01.11.2006, në pozicionin “*Inspektore e tatim-taksave*”, me emërim, pa kryer procedurë konkurrimi. Në pozicionin aktual, “*Shefe e Sektorit të Tatim Taksave*”, ka kaluar me vendimin e titullarit nr. 12, datë 21.02.2014 “*Emërim në detyrë*”, (përsëri, pa procedurë konkurimi për ngritje në detyrë), por që është vënë në zbatim ditën e fillimit të marrëdhënies financiare në dt. 01.04.2014.

Në këtë rast, ndodhemi në kushtet e analizuar në rastin e punonjësës, Zonja Qesargjoni, kur marrëdhënia financiare ka filluar pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe për këtë arsye, emërimi i nëpunësës ***** në pozicionin “*Përgjegjëse në Sektorin e Tatim Taksave në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike*”, duke mos respektuar procedurën ligjore për pranimin në shërbimin civil, është një veprim administrativ në kundërshtim me ligjin.

Në këtë kuptim, pozicioni i punës “*Shefe e Sektorit të Tatim Taksave, në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike*”, duhet të deklarohet si pozicion i lirë dhe për plotësimin e tij, duhet të zhvillohet procedura ligjore e rekrutimit.

Nga ana tjetër, nisur nga fakti që punonjësja ***** ditën e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka qënë efektivisht në pozicionin “*Inspektor*

kontrolli dhe vlerësimi tatimor”, rezulton se akti i deklarimit të statusit të punësimit, me nr. 8 prot., datë 24.03.2014, që e ka konfirmuar këtë punonjëse me statusin e nëpunësit civil, në këtë pozicion, është një akt ligjshëm.

Akti i dytë i deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin *“Shefe e Sektorit të Tatimeve”*, me nr. 24 prot., i cili ka dalë po në datën 24.03.2014, është një akt i paligjshëm dhe si i tillë, duhet të revokohet nga organi që e ka nxjerrë, pasi siç u tha edhe më lart, në dt. 26.02.2014, ditën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, marrëdhënia e punës në pozicionin *“Shefe e sektorit të tatimeve”*, nuk ka qënë efektive, e për këtë shkak, punonjësja nuk mund të përfitojë nga mundësia që i njeni 67 i ligjit në fjalë.

3. *****, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 21 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin *“Inspektor Kontrolli dhe Vlerësimi Tatimor në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”*.

Marrëdhënia e punës në pozicionin aktual ka filluar në bazë të vendimit të titullarit nr. 10, datë 21.02.2014 *“Transferim në detyrë të një niveli më të ulët”* dhe është bërë me me dëshirën e nëpunësit. Marrëdhënia financiare në këtë rast, ka filluar në datën 01.04.2014.

Nga hetimi administrativ, rezulton se ditën e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, punonjësi ***** ka qënë në detyrën *“Drejtore Finance”* dhe në këtë pozicion duhej të merrte aktin e deklarimit të statusit të punësimit. Në kushtet e sotme, kur me pëlqimin e tij, ka kaluar në një detyrë të një niveli më të ulët *“Inspektor Kontrolli dhe Vlerësimi Tatimor”*, detyrë të cilën e kryen aktualisht, njësia e personelit duhet të bëjë deklarimin e statusit të nëpunësit civil të konfirmuar, në pozicionin që mban sot, *“Inspektor i Kontrollit dhe Vlerësimit Tatimor”*, duke e ndërprerë periudhën e provës.

4. *****, në pozicionin *“Drejtore në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit”*, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 6 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil në periudhë prove.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum, në pozicionin aktual, e ka filluar me vendimin e titullarit nr. 9, datë 03.02.2014 *“Emërim në detyrë”* dhe në zbatim të kontratës individuale të punës, me nr. 213 prot., datë 03.02.2014, (pa procedura rekrutimi). Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ky nëpunës e kishte filluar marrëdhënien e punës, por nuk e kishte plotësuar ende një vit, prandaj me të drejtë, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, është deklaruar nëpunës civile në provë, në në pozicionin *“Drejtore në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit”*.

5. *****, në pozicionin *“Inspektore Shërbimesh (inxhinier) në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Punëve Publike”*, deklaruar statusi i punësimit, me aktin nr. 22 prot., datë 24.03.2014, si nëpunëse civile në periudhë prove.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum në pozicionin aktual, e ka filluar me vendimin e titullarit nr. 8, datë 03.02.2014 *“Emërim në detyrë”* dhe në zbatim të kontratës individuale të punës, me nr. 210 prot., datë 03.02.2014 (pa procedura konkurrimi) e në të njëjtën kohë ka filluar edhe marrëdhënia financiare. Duke qënë se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kjo nëpunëse ishte në marrëdhënie pune, por ende nuk e kishte plotësuar periudhën një vit, me të drejtë, njësia e personelit, bazuar në

nenin 67, pika 4 të ligjit në fjalë, ka deklaruar statusin e punësimit “*Inspektore Shërbimesh (inxhinier) në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Punëve Publike*”, në periudhë prove.

6. *****; në pozicionin “*Kryeinspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit*”, deklaruar statusi i punësimit me aktin nr. 19 prot., datë 24.03.2014, si nëpunës civil në periudhë prove.

Marrëdhënien e punës me institucionin e Bashkisë Orikum, e ka filluar në dt. 02.02.2009, kur është emëruar në pozicionin “*Kryeinspektor në Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik Vendor*. Me tej, me vendimin e titullarit nr. 30, datë 01.10.2013 “*Emërim në detyrë*”, është emëruar në pozicionin “*Kryeinspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit*”, në të njëjtin nivel punësimi. Në këto rrethana, kur fillimi i efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, pa të drejtë, është konsideruar nëpunës civil në periudhë prove, pasi ai, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, e kishte përfituar statusin e nëpunësit civil, në pozicionin “*Kryeinspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit*”. Në këto kushte duhet të ndryshohet akti i konfirmimit, duke pasqyruar faktin e ndërprerjes së periudhës së provës dhe punonjësi të konsiderohet me statusin e nëpunësit civil të konfirmuar.

II. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil

Ligji nr. 153/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (Kreu XI, neni 62), përcakton detyrimin e institucioneve për të kryer vlerësimin vjetor të punës për secilin punonjës që kryen funksione në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Vlerësimi i performancës ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil në disa drejtime, ndër të cilat mund të përmëdim, konfirmimin e tij në fund të periudhës së provës; ndërprerjen e marrëdhënies së punës pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme negative; zhvillimin e sistemit të karrierës, si për rastet e lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë, si dhe luan një rol të rëndësishëm për risistemimin e nëpunësit në një rast ristrukturimi apo shkurtimi të vendit të punës.

Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave, të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj (*pika 1, neni 62*).

Përveç vlerësimit, sipas paragrafit të mësipërm, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas përcaktimeve me vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*” edhe për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, në përputhje me kategorinë/grupin e administrimit të përgjithshëm/posaçëm ku bëjnë pjesë.

Nëpunësi mund të vlerësohet në një nga këto nivele:

- a) “shumë mirë” (1);
- b) “mirë” (2);
- c) “kënaqshëm” (3);
- ç) “jokënaqshëm” (4).

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë, a) është procesi vjetor i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive,

apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave dhe b) shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirimin nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet çdo vit dhe viti i vlerësimit është i njëjtë me vitin kalendarik. Në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, viti i vlerësimit llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Sa më sipër, ç'ka pasqyrojnë rregullime të posaçme të parashikuara shprehimisht në ligjin dhe aktet nënligjore që disiplinojnë fushën e shërbimit civil në lidhje me këtë institut të rëndësishëm, janë mbajtur parasysh nga njësia përgjegjëse në subjektin e inspektuar, e cila ka si detyrim ligjor drejtimin e këtij procesi dhe koordinimin e punëve me të gjithë pjesëmarrësit në të.

Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces i vështirë që kërkon punë sistematike dhe të materializuara në shënime sistematike, nominale nga ana e punonjësve të ngarkuar me implementimin e tij, të cilët paraqiten në rolin e Zyrtarit Autorizues dhe Kundërfirmues, për nëpunësit civil në pozicionin që i përket shërbimit civil.

Pas kontrollit të ushtruar në lidhje me procesin e vlerësimeve vjetore të nëpunësve, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, u konstatua se, vlerësimet e rezultateve individuale në punë, për periudhën 2013 – 2014, të gjithë nëpunësit civil të Bashkisë Orikum, ishin në nivelin 1 “*shumë mirë*” dhe 2 “*mirë*”.

Kjo situatë, pavarësisht vështirësisë së procesit për të matur nga jashtë saktësinë dhe eficiencën e akteve të kësaj natyre nga ana e eprorit, tregon për ekzistencën e elementeve të një qëndrimi subjektiv dhe formal.

Për më tepër, këtë përfundim e mbështet fakti që vlerësimet për zërat e ndryshëm të procesit, nuk janë të shoqëruara me vërejtje apo komente konkrete, pozitive ose negative, për secilin nëpunës të vlerësuar.

Megjithatë, duhet të vlerësojmë pozitivisht në këtë rast, faktin se nga pikpamja formale, janë bërë përpjekje nga njësia përgjegjëse dhe aktorët e procesit, për të zbatuar drejt ligjin në lidhje me këtë institut të tij, duke e zhvilluar procesin e vlerësimit sipas formularit standard të miratuar me Vendimin nr.109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”.

III. Pasqyrimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit në dosjen e personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit të inspektimit, si dhe për të verifikuar dokumentimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit, u këqyrën të gjitha dosjet e personelit për të konstatuar nëse ato janë krijuar dhe administruar në përputhje me kërkesat e nenit 17 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të*

personelit” dhe nëse administrohet në to, dokumentacioni që materializon procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit që u gjenden në marrëdhënie pune me pozicione pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit në fjalë.

Nga këqyrja e këtyre akteve për çdo nëpunës civil, u konstatua se janë të përfshira në dosjet e personelit dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas kërkesave të lidhjes nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 117 dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumentat e identifikimit (*fotokopje e pasaportës*); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (*çertifikata e gjëndjes familjare*); dokumenta që vërtetojnë edukimin arsimor (*diploma e shkollës së lartë*); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (*çertifikata kualifikimi*), çertifikata e gjendjes gjyqësore, e dokumeta të tjera që tregojnë dinamikën e marrëdhënies së punësimit për çdo rast.

b. Rregjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument i krijuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që është përgjegjësi e Departamentit të Administratës Publike, për t`u administruar, në një mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i institucionit të inspektuar, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Specialisti i Burimeve Njerëzore, që në momentin e inspektimit ka qenë nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

III. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Administrimi i shërbimit civil, është një proces i rëndësishëm, i cili duhet të realizohet duke u drejtuar nga ligji, për të siguruar respektimin e parimeve të këtij procesi, që synojnë në vendosjen e palëve përballë shanseve të barabarta, zhvillimin e një karriere të bazuar në meritë, mosdiskriminimin e palëve në proceset e administrimit, profesionalizmit të administratës, sigurimin e transparencës dhe paanësisë politike, si dhe të garantohet qëndrueshmëria në detyrë e nëpunësit civil dhe vazhdimësia në shërbimin civil.

Ndonëse efektet e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar kanë filluar prej më se dy vjetësh, nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Orikum, konstatohet një harmonizim i pjesshëm me parashikimet e tij dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Pavarësisht faktit që

korniza ligjore e cila rregullon fushën e shërbimit civil është e plotësuar, duke përcaktuar me qartësi kushtet dhe hapat që duhet të ndërmarrin institucionet shtetërore që i nënshtrohen fushës së zbatimit të tij, vërehet zbatim jo i plotë i ligjit nga ana e institucionit të mbikëqyrur.

Në këtë kontekst konstatohet se, ndonëse janë bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet ligjore, në disa raste nuk janë respektuar e përmbushur plotësisht normat dhe standardet e përcaktuara. Konstatohet se në disa raste, nga ana e institucionit ndeshemi me një interpretim jo të saktë të ligjit nr. 152/2103, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ashtu si u parashtrua më sipër, ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, përcakton procedurën e konkurrimit si mënyrën e vetme të pranimit në shërbimin civil në pozicionet e nivelit ekzekutiv, por edhe në rastet e ngritjes në detyrë. Në këto kushte, ky ligj e ndalon emërimin me akte emërimi pa zhvilluar konkurimin, apo emërimin duke aplikuar kontrata të përkohshme punësimi, sipas Kodit të Punës, duke e urdhëruar shprehimisht se këto akte, janë absolutisht të pavlefshme, ç`ka nuk është mbajtur parasysh në të gjitha rastet nga njësia përgjegjëse.

Njësi përgjegjëse duhet të përfaqësojë një nivel më të lartë ndërgjegjësimit dhe përgjegjësie, jo vetëm në planifikimin e vendeve të lira në shërbimin civil, por edhe në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucione të tjera, që janë pjesë e skemës së administrimit të shërbimit civil dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, si Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla e Administratës Publike (ASPA).

Një bashkëpunim më i ngushtë i njësisë përgjegjëse, kërkohet edhe me nëpunësit civil të institucionit, me qëllim identifikimin e nevojave të tyre për trajnim, duke shfrytëzuar dhe rrugët e bashkëpunimit me Shkollën e Administratës Publike, apo edhe mundësi të tjera, të cilat sjellin ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të nëpunësve të institucionit në të gjithë drejtimit e kërkuar nga ligji.

Nisur nga rrethanat e reja në të cilat do të vijojë administrimi i shërbimit civil në institucionet e administratës vendore, në kuadër të riorganizimit të pushtetit vendor, del si domosdoshmëri që të zbatohen me saktësi përfundimet e arritura në këtë material, për sejcilin rast, duke identifikuar qartë nëpunësit, të cilët përfitojnë nga ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi ata gëzojnë të gjitha të drejtat e sanksionuara në këtë ligj.

*

* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë inspektimit tematik të kryer në Bashkinë Orikum, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Të gjitha rekomandimet e dhëna në këtë material duhet të zbatohen nga njësi përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, e cila është përgjegjëse në lidhje me administrimin e mëtejshëm të shërbimit civil në këtë njësi administrative.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, janë materializuar në tabelën si më poshtë:

- *Aneksi 1 “Organigrama dhe historiku i marrëdhënies me shërbimin civil të punonjësve të Bashkisë Orikum”.*

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA